



Menaxhimi i transmetimeve audiovizive në kushtet e përhapjes së COVID-19

Arben Muka

Pandemia Covid-19 u përhap kudo dhe preku gjithë sistemin. Masat dhe protokollet e autoritetit shëndetësor publik, prej marsit të vitit 2020, kur Shqipëria regjistroi viktimën e parë njerëzore, diku ndaluan, diku reduktuan e ngadalësuan veprimtaritë e qytetarëve, funksionalitetin e institucioneve, sipërmarrjeve - gjithkund, duke përfshirë dhe ato më jetiket. Tregu audio dhe audioviziv nuk mund të ishte i përjashtuar nga lockdown-i dhe efektet zinxhir nga përhapja e përshpejtuar e virusit. Në momentin kur qytetarët “e ngujuar” në banesat e tyre apo në rezidenca larg zonave urbane, duke përcjellë pasiguri dhe dilema mbi atmosferën pandemike, nevoja për informacion u disafishua. Po kështu dhe për njoftimet mbi orientimin (edukimin) shëndetësor, si dhe për argëtimin (si antidote efikase kundër stresit dhe ankthit).

Tregu audio e audioviziv në kushtet e rritjes së kërkesës nga audienca, nisi të përballej me problematika të pahasura më parë. Oferta e subjekteve audio dhe audiovizive të licencuara ishte e tronditur dhe e drobitur. Imagjinoni që jeta e gazetarëve dhe ekipeve mbështetëse në redaksi, studio, impiante e terren ishte e rrezikuar nga infektimi. Disa nga programet televizive me prezencë të publikut u ndërprejnë. Formatet e debateve televizive me karakter politik, ekonomik, social, kulturor etj., që normalisht kishin në studio disa të ftuar, u detyruan të përshtaten me komunikim në distancë, duke futur në lojë lidhjet me skype.

Por menaxherëve të transmetuesve audio dhe audiovizivë, në kushtet e lockdown-it gjatë pranverës së vitit 2020, turbullimin më të madh ua shkaktoi marrëdhënia me blerësit e kohës për reklamë e promocion. Një nga një porositësit e publicitetit filluan të tërhiqen nga kontratat të cilin ishin nënshkruar para pandemisë. Në rastin më të mirë kontratat “ngrinë” për t’u riaktivizuar në një kohë që asnjëra palë nuk mund ta parashikonte. Redaksitë radiofonike nga kufizimi i thellë i qarkullimit rrugor humbën “bastionin” e tyre, ndjekësit mobile në bordin e qindra-mijë automjeteve që qarkullojnë çdo ditë në të gjithë territorin e vendit. Sigurisht që kjo i stepi dhe i ndryshoi mendjen kontraktorëve promociionalë përmes valëve të radios.

Goditja e zërit kryesor të të ardhurave për redaksitë audio dhe audiovizive përbënte një goditje të rrezikshme, që nisi të shoqërohej me shkurtime të personelit si dhe me atrofizim të katalogut programor për transmetim. Nevoja diktonte dhe disa shpenzime shtesë për subjektet audio dhe audiovizive, të cilat lidheshin me përshtatjen (riarredimin) e mjediseve të personelit për respektimin e distancimit social, blerjet e dezinfektantëve dhe inventarit mbrojtës etj.

Situata me tregun audio dhe audioviziv kishte një pamje joproporcionale ku ishin mbivendosur, nga njëra anë kërkesa e jashtëzakonshme e audiencës me “antena ngritur” (si

asnjëherë më parë) për përmbajtje të transmetuar dhe nga ana tjetër, pafuqia për ofertë nga redaksitë.

Pjesë e fushatës së informimit dhe ndërgjegjësimit

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, si rregullator i tregut audio dhe audioviziv, ndikoi në të paktën dy aspekte emergjente në rrethanat e krijuara prej pandemisë COVID-19.

Së pari, nxitjen e angazhimit të operatorëve që të zbatonin kërkesat e ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht të nenit 34, që flet për “Informacionet që transmetohen pa shpërblim”. Në kushtet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë vendin (pas vendimit të qeverisë më 24 mars 2021), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe agjencitë në varësi të saj shpërndanin periodikisht njoftime dhe udhëzime për popullatën në formën e situatave të aktualizuara mbi numrin e të prekurve, të atyre që nuk kishin arritur t’i bënin ballë virusit, si dhe të shëruarve; gjithashtu dhe informacione praktike të dobishme higjieno-sanitare mbi parandalimin dhe përbalimin e infektimit me COVID-19.

Të gjitha subjektet audio dhe audiovizive u treguan të gatshme për emetimin falas të këtij fluksi njoftimesh dhe këshillash didaktike për të përbaluar valën goditjeve pandemike. Duhet shtuar këtu dhe përpjekja e jashtëzakonshme e redaksive për mbulimin e dinamikës orë pas ore të situatës me koronavirusin, ku krahas lajmeve dhe kronikave mbi situatën në terren, kishte dhe intervista, opinione, deklarata, biseda e forume me ekspertë të fushës, të cilët sqaronin dhe analizonin aktualitetin dhe pritshmërinë. Në kushtet e kufizimeve dhe bllokimeve nga masat antiCOVID-19, ekipet e gazetarëve, reporterëve dhe bashkëpunëtorëve ishin ndër kategoritë e pakta që lëviznin në rrugët e institucionet e zbrazura prej lockdown-it. Së dyti, siguria e qëndrueshme për jetën e personelit të angazhuar brenda ose jashtë mjediseve të redaksive, studiove etj. Numri i pjesëmarrësve dhe distancimi social mes moderatorëve dhe të ftuarve në programet e drejtpërdrejta apo të regjistruara u bë objekt monitorimi dhe shqyrtimi për AMA-n. Kjo kërkesë e masave dhe protokolleve të shpallura përmes një akti normativ nga autoriteti shëndetësor publik gjeti mbështetje në shkallë të gjerë nga operatorët e licencuar. Vetëm në tri raste AMA identifikoi shkelje, për të cilat dërgoi shkresa me tërheqje vëmendjeje.

Tipare të ofertës programore

Transmetimet audio dhe audiovizive në kushtet e pandemisë humbën larminë tematike, veçanërisht gjatë pranverës së vitit 2020. Nga katalogët programorë u kufizuan në mënyrë drastike hapësirat e përmbajtjeve kulturore e sportive, rubrikat arsimore e rinore, ndërkohë që dhe temat politike, sociale e ekonomike lidheshin vetëm me ndikimin dhe efektet e shkaktuara nga COVID -19. Reporterët dhe redaktorët e sektorëve tematikë nuk mund të vijonin punë normalisht në një kohë kur kalendarët e aktiviteteve ishin të bllokuara. Morën hov emisionet debatuuese, sigurisht duke mbetur te i njëjti fokus: koronavirusi.

Pikat referenciale të diskutimit mes ekspertëve të shëndetit, ligjvënësve, aktivistëve të shoqërisë civile dhe gazetarëve ishin jo të qëndrueshme për shkak të të panjohurave të

transmetimit tek njerëzit të virusit, parandalimit dhe protokolleve në përballjen me infektimin. Për shkak të kufizimeve dhe bllokimeve të qarkullimit, informacioni nga terreni prezantohej thuajse tërësisht tek hyrja e Spitalit Infektiv në Qendrën Spitalore Universitare në Tiranë. Shpërndaheshin vetëm shifrat zyrtare për numrin e të prekurve, të atyre që nuk ia kishin dale dot, apo ata që fati i kishte ndihmuar të shërohen. Evidenca vetëm nga një burim. Nuk mund të bëhej fjalë për investigime apo kontribute vëzhgimesh të pavarura mbi situatën. Oponenca “ra në duart” e deklarimeve hamendësuese të aktorëve politikë, apo personave publikë të lidhur me politikën. Nuk ka pasur ndonjëherë më shumë info të paverifikuara apo teori konspirative se sa në rastin e pandemisë. Sigurisht që këto të fundit gëlojnë në periudhat e krizave afatgjata, ndaj dhe dukshëm ato ishin në shtratin e tyre.

Pavarësisht kushteve të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, detyrat e subjekteve audio e audiovizive sa i takon përmbajtjeve të transmetuara nuk kanë pasur ndryshim, bazuar në kërkesat e nenit 33 të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Një subjekt i licencuar duhet që dhe: të njoftojë dhe të paraqesë lajmet e transmetuara në një mënyrë të vërtetë, të paanshme dhe objektive; të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme; të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale.

Por jemi në kushte specifike. Kur në zhargonin e përditshëm të autoriteteve lakoheshin më shumë fjalët “luftë” e “armik i padukshëm”, kur regjistroheshin çdo ditë humbje jetësh njerëzore. Nga ana tjetër dukej qartë se vetë sektori shëndetësor, njësitë e studimit dhe kërkimit shkencor në këtë fushë shfaqen të papërgatitura për mjaft dukuri dhe procese gjatë pandemisë. Jo vetëm për të karakterizuar tiparet e sjelljen e virusit vrastar, por dhe për masat e protokollit parandalues. Kjo reflektohej dhe në dyzimin e ekspertëve kur ata iu drejtoheshin publikut nga studiot radiofonike e televizive. (Ju kujtohen vlerësimet kundërthënëse mbi përdorimin e maskave mbrojtëse në ambientet e brendshme ose të jashtme, apo mbi mënyrat e transmetimit të infektimit në radhët e popullatës). Ndaj dhe përgjegjësia e përhapjes së informatave dhe këshillave për publikun përmes mjeteve të informimit masiv merrte një rëndësi të veçantë në rrethana të tilla.

Ka qenë një sfidë reale e redaksive audio dhe audiovizive, menaxhimi i linjës editoriale në fluksin e informacionit mbi dinamikën e zhvillimit të ngjarjeve të aktualitetit si dhe pritshmërinë. Pjesa më e madhe e redaksive iu referua pikëpamjeve dhe arsytetimeve nga ekspertët më të mirë të shëndetit publik, mjekë nga më të njohurit dhe kompetentët në vend, por dhe nga ata shqiptarë që përballja me COVID-19 bëhet në spitale dhe institucione shëndetësore në vende të ndryshme të Evropës, SHBA etj.

Në disa programe televizive tendosja dhe shqetësimi me goditjet që po jepte koronavirusi me humbje jete njerëzore po përcillej tek audience përzierë dhe me nota shpotitëse e relaksuese. U ftuan do “ekspertë” me profil inxhinierik, juridik, bujqësor a veteriner, të cilët ofruan “receta” të zhdukjes së menjëhershme të virusit, si kombinime të pijeve alkoolike me përbërës të ekstrakteve bimore e shtazore, me qepë, hudhra, xhinxher me të brendshme keci etj etj. Titujt për këto intervista e biseda, si psh., “gjendet ilaçi kundër COVID 19”, apo “zbulohet mrekullia antikoronavirus” ishin më tepër si injeksione humori në emisionet televizive, për të shtensionuar situatën. Moderatorët dhe redaktorët që ideonin dhe realizonin të tilla thagma “shkencore-popullore” harronin kontekstin: se dita-ditës pasojat e

koronavirusit shkaktonin humbje jetësh, krijonin pikëllim dhe stres te familjarët, të afërmit dhe miqtë të cilët nuk mund të bënin as respektin minimal të pjesëmarrjes në funerale, mbanin të rënduar psikologjikisht shumë të tjerë që ende nuk ishin prekur.

Kauzat alternative përmes ekranit

Si kudo në rruzull, edhe në Shqipëri doli në pah një bërthamë konsiparacionistësh, mosbesuesish që i jepnin liri fantazisë së tyre mbi atë që kishte ndodhur, që po ndodhte, e për pritshmërinë. Duke apeluar që t'u afrohen dhe të tjerë, duke ngritur zërin në mjediset publike (organizuan dhe një marrshim proteste në mes të Tiranës gjatë muajit qershor 2020), ata nuk ishin thjesht mosbesues për koronavirusin, nuk ishin kundër vaksinimit masiv të popullatës (megjithëse vakcina ende nuk dukej në horizont në atë kohë), por aludonin se gjithçka “kurdisej” ishte në dëm të interesit kombëtar, deri dhe “plan i mirëstrukturuar për shfarosje të shqiptarëve kudo janë”..

Forma e mbulimit të këtij aksioni të konspiracionistëve nga redaksitë audiovizive ishte e ndryshme. Disa e injoruan totalisht. Disa ishin në të kundërt, duke iu kushtuar hapjen e edicioneve informative. Një pjesë e televizioneve e mbuluan si lajm periferik përmes kronikave të shkurtra, ku binte në sy se teksti dhe pamjet e zgjedhura krijonin më shumë atmosferë sarkastike për shikuesit.

Duke qenë pjesë e debatit publik, zëra nga grupimet alternative për COVID-19 morën hapësira dhe në debatet (forumet) e studiove televizive. Duke qenë në linja të lirshme të mendimit, duke prezantuar teori dhe platforma të autorëve të huaj ata nisën të rivalizojnë dhe ekspertët infeksionistë apo ata të shëndetit publik, duke pretenduar me kurajë se ishin më të saktë dhe më të bazuar se mjekët. Leximi i librave, i artikujve të gazetave, shikimi i dokumentarëve me fantashkencë ju mjaftonte të mbronin teoritë dhe konceptet konspirative, përmes zgjidhjeve jo domosdoshmërisht nga shkenca mjekësore.

Fakt është se jehona e kauzave të grupimeve të tilla, kundërshtare shpjegimeve shkencore dhe sidomos anatemues të fushatave të vaksinimit masiv të popullatës erdhi duke u venitur. Zbehja erdhi dhe për shkak se parashikimet e tyre të artikuluara në ekrane nuk dolën, por u përdorën si lëndë e parë për memet e rrjeteve sociale.

Ndoshta dhe se një pjesë e tyre ose e familjarëve, sipas raportimeve në media, rezultoi se u prek nga koronavirusi, të cilin e më parë e përshkruanin si “imagjinar”.